



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISTINE
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

Bordi i Drejtoreve i NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. – Prishtinë, në votimin virtual te realizuar 01.09.2026, duke u mbështetur të nenit 20 të Ligjit Nr-04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087 për Ndërmarrje Publike, dispozitave të nenit 130 të Ligjit Nr-06/L-016, për Shoqëri Tregtare, në përputhje te nenit 8 pika 8.3 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A. me qëllim të shmangies së diskriminimit, shmangies së kufizimit në konkurrenc dhe krijimit të kushteve të barabarta merr këtë:

V E N D I M

(për plotësim ndryshim të rregullores 02/1400)

- I. Plotësohet dhe ndryshohet Rregullorja për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës, nr. 02/1400, datë 30.07.2026, si në vijim:
 - Neni 18 Pozita e punës "Drejtör i Financave" te pjesa e "Kualifikimi, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara" paragrafi 2 i kualifikimit (5) vite përvojë pune profesionale zëvendësohet me (3) vite përvojë pune profesionale.
 - Faqe 55 pozita e punës "Drejtör i Marketingut dhe Digjitalizimit" në faqe 56 te pjesa e "Kualifikimi, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara" paragrafi 2 i kualifikimit (5) vite përvojë pune profesionale zëvendësohet me (3) vite përvojë pune profesionale.
 - Faqe 43 pozita e punës "Zyrtar për Hulumtim të Tregut dhe Implementim të Kontratave" te pjesa e "Kualifikimi, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara" paragrafi 1 Diplomë universitare - drejtimi Drejtësi ose Ekonomi zëvendësohet me Studime universitare – niveli Bachelor (së paku 180 ECTS).
 - Faqe 77 pozita e punës "Zyrtar për Pranimin e Ankesave" te pjesa e "Kualifikimi, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara" paragrafi 2 largohet kriteri.
 - Faqe 38 pozita e punës "Zyrtar i Kontrollës së Brendshme Inspektuese" te pjesa e "Kualifikimi, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara" paragrafi 2 largohet kriteri.
 - Faqe 49 pozita e punës "Udhëheqës i Zyrës Ligjore" te pjesa e "Kualifikimi, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara" paragrafi 1 riformulohet në, Studime universitare – Bachelor në fushën juridike, paragrafi 2 riformulohet në, 1 vitë përvojë pune pas diplomimit.
- II. Të gjitha dispozitat e tjera të Rregullores nr. 02/1400, datë 30.07.2026, të cilat nuk preken nga ky vendim, mbeten në fuqi dhe zbatohen pa ndryshim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me qëllim të sigurimit të parimeve të mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë dhe krijimit të kushteve të barabarta për të gjithë kandidatët, si dhe shmangies së kufizimeve të panevojshme në konkurrencë dhe pasojave të mundshme administrative-juridike, Bordi i Drejtorëve, pas shqyrtimit, vlerësoi të domosdoshme ndryshimin e kriterëve të përcaktuara në dispozitivin e këtij Vendimi.

Ndryshimet synojnë harmonizimin dhe qartësimin e kriterëve të rekrutimit, në mënyrë që ato të jenë objektive, proporcionale dhe të ndërlidhura me kërkesat e pozitave përkatëse.

Në këtë drejtim, Bordi i Drejtorëve veproi në mbështetje të kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Statutin e Ndërmarrjes, si dhe dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Ti dergohet:

1x1 Kryeshefit Ekzekutiv

1x1 Sekretarit

1x1 Arkivës

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve
NPL "Stacioni i Autobuseve" Sh.A. – Prishtinë
Z. Shaban Brahimaj

